



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A  
DEPARTAMENTI LIGJOR DHE I PROKURIMEVE  
DREJTORIA E PROKURIMEVE  
SEKTORI I MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** “Blerje kimikate për UKT sh.a” të ndarë në lote:

- Loti 1: “Blerje Hipoklorit Natriumi 13-15%”
- Loti 2: “Blerje Acid Klorhidrik 30-33%”
- Loti 3: “Blerje Poliklorur Alumini 10±0.5 %”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kimikate  
për trajtimin e ujit**

**VLERA E FONDIT LIMIT TË PËRGJITHSHËM:**

1. Fondi limit për të tre lotet : 209 959 375(dyqind e nente milion e nenteqind e pesedhete e nente mijë e treqind e shtatedhete e pese )leke pa tvsh.

Vlera e fondit limit për 3 lote ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise është 2.024.680,57 (dy milion e njezet e kater mije e gjashteqind e tetedhete presje pesedhete e shtate) euro pa tvsh.

Kursi zyrtar i kembimit për monedhën euro sipas Bankes te Shqiperise datë 19.12.2023 është 103.07.

Fondi limit për lotin1: Loti 1:“Blerje Hipoklorit Natriumi 13-15%” me fond limit 69.474,375 (gjashtedhete e nente milion e katerqind e shtatedhete e kater mije e treqind e shtatedhete e pese ) lekë pa tvsh.

Vlera e fondit Limit ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise për lotin e 1 është 669.995,4 (gjashteqind e gjashtedhete e nente mije e nenteqind e nentedhete e pese presje kater ) euro pa tvsh.

Kursi zyrtar i kembimit për monedhën euro sipas Bankes të Shqipërisë datë 19.12.2023 është 103.07.

Fondi limit për lotin 2: Loti 2: “Blerje Acid Klorhidrik 30-33%” me fond limit 63.925,000 (gjashtëdhjetë e tre milion e nentëqind e njëzet e pesë mijë) lekë pa tvsh.

Vlera e fondit Limit në monedhën ndërkombëtare Euro sipas kursit të Bankes së Shqipërisë për lotin e 2 është 616.441,659 (gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e katërqind e dyzet e një presje gjashtëqind e pesëdhjetë e nente) euro pa tvsh.

Kursi zyrtar i kembimit për monedhën euro sipas Bankes të Shqipërisë datë 19.12.2023 është 103.07.

Fondi limit për lotin 3: Loti 3: “Blerje Poliklorur Alumini 10±0.5 %” me fond limit: ( 76.560,000) shtatëdhjetë e gjashtë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë ) lekë pa tvsh.

Vlera e fondit Limit në monedhën ndërkombëtare Euro sipas kursit të Bankes së Shqipërisë për lotin e 3 është 739.283,51 (shtatëqind e tridhjetë e nente mijë e dyqind e tetëdhjetë e tre presje pesëdhjetë e një) euro pa tvsh,

Kursi zyrtar i kembimit për monedhën euro sipas Bankes të Shqipërisë datë 19.12.2023 është 103.07.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar autoriteti/enti kontraktor UKT sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Loti 1:** “Blerje Hipoklorit Natriumi 13-15%”

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 përkatësisht për lotin e 1 “Blerje Hipoklorit Natriumi 13-15%” është 1,389.487,50 (një milionë treqind e tetëdhjetë e nente mijë e katërqind e tetëdhjetë e shtatë presje pesëdhjetë) lekë si dhe në monedhën euro 13,399,11 (tremëndhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e nente mijë presje njëmbëdhjetë) euro.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

## 2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

---

### 2.2 Kapaciteti ekonomik –financiar

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit të lotit të parë.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Nëse operatori ekonomik oferton për lote të veçanta, vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës të kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të lotit përkatës, ose shumë se loteve që oferton).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, pika 2, si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike".

**2.2.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kriteri quhet i përmbushur nëse në bilancet e 2 viteve të njëpasnjëshme nuk kanë raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, rekomandimit të Agjencisë të Prokurimit Publik nr.7998, datë 24.12.2021.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

**2.2.3.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2023)**, në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

*(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*

**2.2.4.** Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2023 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas pranë bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

### **2.3Aftësitë teknike dhe profesionale:**

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limitit të lotit të parë, / shumatores së loteve për të cilën oferton.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara, ose
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77/4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit të lotit të parë/ shumatores së loteve për të cilën oferton., që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

- c) Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:  
Vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e fondit limit.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

---

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

## **Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

### **2.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë:**

- Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor . Në rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna

të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 73 datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar neni 40, pika 6, germa “c”, i jep mundësinë autoriteteve kontraktorë t’u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses.

Për autoritetin është e rëndësishme që të sigurohet “mall” sipas standardeve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për tu paraqitur është i parashikuar dhe brenda kuadrit ligjor të parashikuar në dispozitat ligjore.

**2.5** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Të disponojë Çertifikatën mbi “Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” ISO 9001:2015 (**ose ekuivalente**) e vlefshme. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

**2.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- b) Të disponojë Çertifikatën mbi “Sistemet e Menaxhimit të Ambjentit” ISO 14001:2015 (**ose ekuivalente**) e vlefshme. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

**2.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Të disponojë Çertifikatën **SSH 45001:2018** e vlefshme mbi “Sistemin për Menaxhimin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë”. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

*ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.*

*14001:2015 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit mjedisor që një organizatë mund të përdorë për të përmirësuar performancën e saj mjedisore. ISO 14001:2015 është menduar për përdorim nga një organizatë që kërkon të menaxhojë përgjegjësitë e saj mjedisore në një mënyrë sistematike që kontribuon në shtyllën mjedisore të qëndrueshmërisë. ISO 14001:2015 ndihmon një organizatë të arrijë rezultatet e synuara të sistemit të saj të menaxhimit mjedisor, të cilat ofrojnë vlerë për mjedisin, vetë organizatën dhe palët e interesuara.*

*ISO 14001:2015 është i zbatueshëm për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia, lloji dhe natyra, dhe zbatohet për aspektet mjedisore të aktiviteteve, produkteve dhe shërbimeve të saj që organizata përcakton se mund t'i kontrollojë ose ndikojë duke marrë parasysh perspektivën e ciklit jetësor.*

*Çertifikata SSH 45001:2018 e vlefshme mbi “Sistemin për Menaxhimin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë”.*

*Standardi ISO 45001 i Sistemit të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë do të sigurojë një përfitim të rëndësishëm në parandalimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale që janë një barrë e madhe për bizneset. Standardi ISO 45001 ofron një kornizë për bizneset anëmbanë botës për të zvogëluar rreziqet në vendin e punës, për të rritur sigurinë e punonjësve dhe për të krijuar kushte më të besueshme të punës dhe përfshin kërkesa për të zvogëluar barrën ndaj tyre.*

**2.8.**Në rast se operatori ekonomik ofertues nuk është prodhues operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë vetëdeklarim me anë të së cilës duhet të deklarojë se mallrat janë konform normave SSH EN 901;2013).

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit në sistemin elektronik.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, çertifikatën e prodhuesit konform normave, SSH EN 901;2013).

**Argumentim:***Njësia e Prokurimit gjykon se paraqitja e çertifikatës që verteton konformitetin e produktit në prokurim me normat SSH EN 901;2013) Produkte kimike për tretimin e produkteve për trajtimin e ujit të destinuar për konsum njerëzor, konform normave të mësipërme, është i rëndësishëm për autoritetin kontraktor në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së mallrave konform normave të mësipërme, për shkak dhe objektit të veçantë jetik siç janë trajtimi i ujit me kimikate me qëllim demonstrimin dhe plotësimin e parametrave të cilësisë si dhe karakteristikat kimike të produkteve të ofruara me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.*

**2.9** Operatori ekonomik ofertues (në rastin kur nuk ehte prodhues) duhet të paraqesë në sistemin elektronik një vetëdeklarim me anë të së cilit duhet të deklarojë se në momentin e dorëzimit të mallit do të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor çertifikatën nr.Rech të prodhuesit i cili vërteton dhe identifikon se prodhuesi(t) është i rregjistruar dhe i çertifikuar për tretimin e produkteve kimike për trajtimin e ujit për konsumim njerëzor.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit në sistemin elektronik.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” .

Çertifikata reach e prodhuesit është një çertifikatë e cila dëshmon se prodhuesi i mallrave operon për të përmirësuar mbrojtjen e shëndetit të njerëzve nga rreziqet që mund të paraqesin kimikatet, se si substanca mund të përdoret në mënyrë të sigurt në shëndetin e popullatës.

Pra duke qënë se furnizimi më ujë i qytetarëve të bashkisë Tiranë është jetik, në mënyrë që trajtimi i ujit me kimikate të përdoret në mënyrë të sigurtë për shëndetin e populates.

**2.10.** Në rast se operatori ekonomik është importues atëherë duhet të paraqesë në sistemin elektronik lejen e importit të lëshuar nga Komisioni i Liçensave pranë Ministrisë së Shëndetësisë për llojet e sasitë e kimikateve të përcaktuara në DST.

Në rast se operatori ekonomik është prodhues vendas atëherë duhet të paraqesë në sistemin elektronik leje mjedisore e tipit A të lëshuar nga QKL për të gjitha kimikatet e kërkuara nga AK.



Në rast se operatori ekonomik është tregtues vendas atëherë operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik kontratë furnizimi me një prodhues vendas shoqëruar me lejen mjedisore e tipit A të lëshuar nga QKL të prodhuesit vendas ose kontratë furnizimi me 1(një) importues të mallrave si dhe lejen e importit të importuesit të lëshuar nga Komisioni i Liçensave pranë Ministrisë së Shëndetësisë për llojet e sasitë e kimikateve të përcaktuara në DST.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në zbatim të ligjit nr.10138, datë 11.05.2009”Për Shëndetin Publik”, ligji nr.10081, datë 23.02.2009”Për liçensat , autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, gjithashtu mbështetur edhe në pikën 1 të Vendimit nr. 415, date 17.08.1993 të Këshillit të Ministrave "Për licencimin eeksportit, importit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të substancave për desinfektim,dezinsektim dhe deratizim" parashikohet se: “Importimi, eksportimi, magazinimi dhe tregtimi me shumicë e pakicë i lëndëve dezinfektante, dezinfektante e deratizuese për persona komunal, në banesa dhe objekte të ndryshme sociale nga persona juridikë e fizikë, si dhe nga individë të ndryshëm, bëhet me leje (licencë) që jepet nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit.

Ky kriter është vendosur në mbështetje të vendimit nr. 379 date 25.05.2016 neni 14, pika 1 në të cilën sanksionohet: “Për trajtimin e ujit të pijshëm lejohet të përdoren vetëm lëndët kimike të miratuara/autorizuara sipas legjislacionit përkatës për produktet biocide” dhe kimikatet objekt prokurimi (produkte biocide) që u lejohet leja e importit janë të përcaktuara në urdhërin nr.202 date 23.05.2014 nga Ministria e Shëndetësisë “Për autorizimin e importit të produkteve biocide dhe miratimin e listës së produkteve biocide për dezinfektimin, deratizimin dhe dezinfektimin në Shëndetin Publik dhe produkteve për trajtimin e ujit të pijshëm të lejuara për tregtim dhe përdorim në Republikën e Shqipërisë.

Referuar vendosjes të lejes mjedisore të tipit A në rastin kur operatori ekonomik është prodhues vendas apo kur operatori ekonomik është tregtues vendas kriteri është vendosur në zbatim të ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011”Për lejet e mjedisit” të ndryshuar.

Në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011”Për lejet e mjedisit” parashikohet se

“Leje mjedisi e tipit A” është leja për veprimtaritë e përcaktuara në aneksin 1/A, e përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe e firmosur nga ministri, të lëshuar nga QKL-ja, që i jep të drejtën e funksionimit, tërësisht ose pjesërisht, instalimit të tipit A, sipas përcaktimit të këtij ligji, dhe që përmban të shkruara kushtet e nevojshme për të garantuar se instalimi përmbush kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi. Një leje mund të mbulojë një ose më shumë instalime ose pjesë të instalimeve në të njëjtën vendndodhje dhe që operohen nga një i njëjti operator.

Në aneksin 1/A parashikohet shprehimisht veprimtaria “Prodhimi i kimikateve inorganike bazë (4.2)”.

Përderisa tipi i lejes A përfshin në veprimtarinë e saj “Prodhimi i kimikateve inorganike bazë (2)” atëherë domosdoshmërisht operatori ekonomik prodhues i interesuar për procedurën objekt prokurimi duhet të jetë i liçensuar për prodhimin e kimikateve inorganike bazë me qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Sa më sipër në vlerësimin e Autoriteti Kontraktor ky kriter ligjor është i domosdoshëm pasi objekti i prokurimit për vetë natyrën e tij ka një impakt social të rëndësishëm pasi bëhet fjalë për ujin e pijshëm ndaj edhe garancitë që Autoriteti Kontraktor synon të përftojë me anë të vendosjes së

*kritereve duhet të jenë të një niveli të lartë për të konkluduar me përmbushjen e suksesshme të kontratës objekt prokurimi.*

2.11 Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik fletën e analizës nga Instituti i Shendetit Publik për analizat si më poshtë :

*Ngjyra dhe Era, Plumbi(Pb), Kadmiumi (Cd),Kromi (Cr), Nikeli(Ni), Densiteti*  
ose

Analizimi i metaleve të rënda të kimikateve të bëhet në një laborator të licensuar (vëndas ose të huaj), Qender Kerkimore (IKV,IFBZ) apo Universitare që ka kapacitete dhe aparatura të analizoje metalet e rënda në produkte të ndryshme, përfshirë dhe kimikatet e sipërpermendura.(Për të gjithë elementet të cilët nuk kryhen nga Instituti i Shendetit Publik).

**Argumentim:** *Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të nenit 40 “të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar në të cilën parashikohet shprehimisht.... Se Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

*b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose*

**c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.**

Sa më sipër në vlerësimin e Autoriteti Kontraktor ky kriter ligjor është i domosdoshëm pasi objekti i prokurimit për vetë natyrën e tij ka një impakt social të rëndësishëm pasi bëhet fjalë për ujin e pijshëm ndaj edhe garancitë që Autoriteti Kontraktor synon të përftojë me anë të vendosjes së kritereve duhet të jenë të një niveli të lartë për të konkluduar me përmbushjen e suksesshme të kontratës objekt prokurimi.

Në mbështetje të bazës ligjore të sipërpërmendur njësia e prokurimit gjykon se vendosja e kërkesës së mësipërme në kushtet e veçanta të kualifikimit AK ka për qëllim të vërtetojë se për produktet që prokurohen nuk do të përmbajnë lëndë të huaja dhe toksike të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e popullatës

2.12.Një punësim mesatar i të paktën 3(tre) personave, për muajin e fundit të vërtetuar me;

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit;
- List pagesat e punonjesve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.

(Nëse operatori ekonomik oferton për lote të veçanta, nr.i punonjësve duhet të korrespondojë numrit të punonjësve të kërkuar në lotin që oferton, ose shumës se loteve që oferton)

2.13.Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të paktën 1 (një) kimist dhe një drejtues mjete ( brenda numrit të kërkuar në pikën 2.12).

- Për punonjës të “Kimist” operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomë, dhe kontratë pune (e vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar)

- Për punonjësin “Drejtues mjete” dokumentat që duhet të paraqes janë: Leje drejtimi për mjete që kryejn transportin e lëndëve të rrezikshme (ADR) (e vlefshme) si dhe te figurojë në listpagesat e muajit të fundit të shoqërisë.
- Për rastin kur mjetet dhe makineritë sigurohen nëpërmjet kontratës së qerasë atehere operatori ekonomik për punonjësin “Drejtues mjete” duhet të paraqesë **kontratë punësimi** për vetëdeklarimet mbi punonjësit e kërkuar në DST.

**Shënim:** Për pikat 2.12, 2.13 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma b), gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Referuar specifikimeve në dosjen e procedurës është përcaktuar se përvec furnizimit të mallit objekt prokurimi do të kryhet edhe shpërndarja e tyre pranë vend-dorezimit te tyre në Impiantin e Trajtimit të Ujit Bovillë), pra për këtë arsye është e domosdoshme që operatorët e mundshëm ekonomikë duhet të dëshmojnë fuqinë e kërkuar punëtore të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimi.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Sa më sipër në vlerësimin e Autoriteti Kontraktor mbi kërkesën e një kimisti është i domosdoshëm pasi objekti i prokurimit për vetë natyrën e tij ka një impakt social të rëndësishëm pasi bëhet fjalë për ujin e pijshëm ndaj edhe garancitë që Autoriteti Kontraktor synon të përftojë me anë të vendosjes së kriterëve duhet të jenë të një niveli të lartë për të konkluduar me përmbushjen e suksesshme të kontratës objekt prokurimi.

*Në specifikimet teknike të procedurës objekt prokurimi përcaktohet se ....*

*Firma furnizuese që nga momenti kur në mënyrë të verbalizuar është lajmëruar për faktin e mospërputhjes së cilësisë së ngarkesës me specifikimet teknike në përputhje me të cilat ka fituar garën, ka 10 ditë kohë për të prezantuar kundërshtitë e veta, në të kundërt e humb këtë të drejtë.*

*Në rastin konkret operatori ekonomik kontraktues ka të nevojshëm disponimin e një kimisti (specialisti të fushës) me qëllim verifikimin e dokumentacionit teknik të produkteve nga ana cilësore dhe e elementëve të sigurisë në rastin kur janë rishitës të mallit, apo në rastin kur janë prodhues të mallrave objekt prokurimi me qëllim verifikimin dhe kontrollin e produktit nga ana cilësore dhe e elementëve të sigurisë, si dhe më pas prezantimin e kundërshtive që mund të ketë operatori ekonomik kontraktues mbi faktin e mospërputhjes të cilësisë të ngarkesës të kimikateve.*

*Sa më sipër në vlerësimin e Autoriteti Kontraktor mbi kërkesën e një kimisti është i domosdoshëm pasi referuar specifikimeve teknike analiza e produktit të reklamuar do të bëhet në bashkëpunim ndërmjet kimistit të impiantit dhe kimistit të shoqërisë kontraktuese në mënyrë që pretendimet e të dy palëve të jenë minimale. Theksojmë se kryerja bashkërisht e analizave të kimistit të UKT sh.a si dhe kimistit të shoqërisë kontraktuese eliminon, minimizon mosmarrvveshjet ndërmjet palëve respektive. Konkretisht në rast se do të kishim mosmarrvveshje në kolaudimin e mallit do të sillte për rrjedhojë bllokim të procesit të punës (trajtimit të ujit me kimikate) dhe për pasojë duke shkaktuar mungesë të ujit tek qytetarët e Tiranës.*

**2.14** Operatori ekonomik për Loti 1“Blerje Hipoklorit Natriumi 13-15%”, duhet të ketë në pronësi ose me qera 2 mjete (autobot) të autorizuar për transport kimikatesh Gjithashtu për transportin e këtyre kimikateve mund të perdoren depozita 1000 l IBC (intermedite bulk container) të jete të vulosura, të pajisura me certifikatat e testimi dhe certifikatat ADR për secilin depozitë, dhe të miratura në përputhje me dispozitat ADR sipas ligjit Nr. 118/2012 „PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME“ për arsye se këto kimikate klasifikohen si produkt ADR me kodet si më poshtë

Kodi UN1791, ADR 1791 solusion HIPOKLORIT NATRIUMI

Kamioni që transporton kimikatet me këto depozita 1000 l duhet gjithashtu të jete i pajisur me certifikate (ADR) për transport lëndesh të rrezikshme (KIMIKATE).

Nëse operatori ekonomik oferton për më shumë se një lot, duhet të vetëdeklarojë, se disponon mjete transporti për secilin nga kimikatet që do të transportojë, sipas specifikimeve teknike të kërkuara për këtë procedurë prokurimi.

Për të vërtetuar disponimin e mjeteve të kërkuara më lart operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

*a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi) për “Transport lende të rrezikshme”, lejen e qarkullimit, plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme) dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme), duhet të shoqerohet me kontratën perkatëse të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jete aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*

b)Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

c)Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

d)Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për mjetet e deklaruar ku të jenë të dukshme dhe targat e mjetit.

e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë në sistemin elektronik se disponon mjete për të realizuar kontratën objekt prokurimi.

**Shënim:** Për pikat 2.14 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Githashtu referuar specifikimeve te administruar ne dosjen e procedures janë përcaktuar përvec furnizimit të mallit objekt prokurimi do të kryhet transporti dhe vendosja e tyre pranë vend-dorezimit te tyre ne destinacionin perkates, për këtë arsye kapaciteti i mjetit për furnizimin e Depove me Hipoklorit Natriumi nuk mund të jetë i njëjtë me tonazhin e mjetit që do të furnizojnë Impiantin e Bovillës, për shkat të terrenit të vështirë në të cilat ndodhen Depot.

Pra për këtë arsye është e domosdoshme që operatorët e mundshëm ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi mbi pajisjet teknike që kanë në dispozicion për të përmbushur kontratën objekt prokurimi.

**2.15.** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, si dhe të gjitha shpenzimet e parashikuara në shtojcën 5 të specifikimeve teknike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë ,markë,emër i veçantë , patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.

## Loti 2“Blerje Acid Klorhidrik 30-33%

### 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

#### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3 për lotin 2 “Blerje Acid Klorhidrik 30-33%” është 1,278.500 (një milion e dyqind e shtatedhjetë e tete mijë e peseqind ) lekë si dhe në monedhën euro 12,328,83 (dymbëdhjetë mijë e treqind e njetzet e tete presje tetëdhjetë tre ) euro.*

#### 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

##### 2.1Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

---

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit të lotit të dytë.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Nëse operatori ekonomik oferton për lote të veçanta, vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës të kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të lotit përkatës , ose shumë se loteve që oferton).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 , pika 1 , pika 2 , si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë

30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike".

**2.2.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kriteri quhet i përmbushur nëse në bilancet e 2 viteve të njëpasnjëshme nuk kanë raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", rekomandimit të Agjencisë të Prokurimit Publik nr.7998, datë 24.12.2021.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

**2.2.3.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2022)**, në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësisve vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

*(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*

**2.2.4.** Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2023 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

### **2.3Aftësitë teknike dhe profesionale:**

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të lotit të dytë, / shumatores së loteve për të cilën oferton.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- d) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,  
ose
- e) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77/4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit të lotit të dytë / shumatores së loteve për të cilën oferton., që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

f) Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e fondit limit.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

---

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një



bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

## **Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

### **2.4. Operatori ekonomik duhet te paraqese:**

- Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor . Në rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vertetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 73 datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar neni 40, pika 6, germa “c”, i jep mundësinë autoriteteve kontraktorë t’u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi. Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses.

Për autoritetin është e rëndësishme që të sigurohet “mall” sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për tu paraqitur është i parashikuar dhe brenda kuadrit ligjor të parashikuar në dispozitat ligjore.

**2.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:**

- c) Të disponojë Çertifikatën mbi “Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” ISO 9001:2015 (**ose ekuivalente**) e vlefshme. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreshjes).

**2.6** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- d) Të disponojë Çertifikatën mbi “Sistemet e Menaxhimit të Ambjentit” ISO 14001:2015 (ose **ekuivalente**) e vlefshme. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

**2.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Të disponojë Çertifikatën **SSH 45001:2018** e vlefshme mbi “Sistemin për Menaxhimin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë”. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

*ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.*

*14001:2015 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit mjedisor që një organizatë mund të përdorë për të përmirësuar performancën e saj mjedisore. ISO 14001:2015 është menduar për përdorim nga një organizatë që kërkon të menaxhojë përgjegjësitë e saj mjedisore në një mënyrë sistematike që kontribuon në shtyllën mjedisore të qëndrueshmërisë. ISO 14001:2015 ndihmon një organizatë të arrijë rezultatet e synuara të sistemit të saj të menaxhimit mjedisor, të cilat ofrojnë vlerë për mjedisin, vetë organizatën dhe palët e interesuara.*

*ISO 14001:2015 është i zbatueshëm për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia, lloji dhe natyra, dhe zbatohet për aspektet mjedisore të aktiviteteve, produkteve dhe shërbimeve të saj që*

organizata përcakton se mund t'i kontrollojë ose ndikojë duke marrë parasysh perspektivën e ciklit jetësor.

Çertifikata SSH 45001:2018 e vlefshme mbi “Sistemin për Menaxhimin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë”.

Standardi ISO 45001 i Sistemit të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë do të sigurojë një përfitim të rëndësishëm në parandalimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale që janë një barrë e madhe për bizneset. Standardi ISO 45001 ofron një kornizë për bizneset anembanë botës për të zvogëluar rreziqet në vendin e punës, për të rritur sigurinë e punonjësve dhe për të krijuar kushte më të besueshme të punës dhe përfshin kërkesa për të zvogëluar barrën ndaj tyre.

**2.8.** Në rast se operatori ekonomik ofertues nuk është prodhues operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë vetëdeklarim me anë të së cilës duhet të deklarojë se mallrat janë konform normave SSH EN 939;2016.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit në sistemin elektronik.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, çertifikatën e prodhuesit konform normave, SSH EN 939;2016).

**Argumentim:** Njësia e Prokurimit gjykon se paraqitja e çertifikatës që verteton konformitetin e produktit në prokurim me normat SSH EN 939;2016 Produkte kimike për tregtimin e produkteve për trajnimin e ujit të destinuar për konsum njerëzor, konform normave të mësipërme, është i rëndësishëm për autoritetin kontraktor në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së mallrave konform normave të mësipërme, për shkak dhe objektit të veçantë jetik siç janë trajtimi i ujit me kimikate me qëllim demonstrimin dhe plotësimin e parametrave të cilësisë si dhe karakteristikat kimike të produkteve të ofruara me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

**2.9** Operatori ekonomik ofertues (në rastin kur nuk ehte prodhues) duhet të paraqesë në sistemin elektronik një vetëdeklarim me anë të së cilit duhet të deklarojë se në momentin e dorëzimit të mallit do të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor çertifikatën nr.Rech të prodhuesit i cili vërteton dhe identifikon se prodhuesi(t) është i regjistruar dhe i çertifikuar për tregtimin e produkteve kimike për trajtimin e ujit për konsumim njerëzor.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit në sistemin elektronik.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” .

Çertifikata reach e prodhuesit është një çertifikatë e cila dëshmon se prodhuesi i mallrave operon për të përmirësuar mbrojtjen e shëndetit të njerëzve nga rreziqet që mund të paraqesin kimikatet, se si substanca mund të përdoret në mënyrë të sigurt në shëndetin e popullatës.

Pra duke qënë se furnizimi më ujë i qytetarëve të bashkisë Tiranë është jetik, në mënyrë që trajtimi i ujit me kimikate të përdoret në mënyrë të sigurtë për shëndetin e populates.

**2.10.** Në rast se operatori ekonomik është importues atëherë duhet të paraqesë në sistemin elektronik lejen e importit të lëshuar nga Komisioni i Liçensave pranë Ministrisë së Shëndetësisë për llojet e sasisë e kimikateve të përcaktuara në DST.

Në rast se operatori ekonomik është prodhues vendas atëherë duhet të paraqesë në sistemin elektronik leje mjedisore e tipit A të lëshuar nga QKL për të gjitha kimikatet e kërkuara nga AK.

Në rast se operatori ekonomik është tregtues vendas atëherë operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik kontratë furnizimi me një prodhues vendas shoqëruar me lejen mjedisore e tipit A të lëshuar nga QKL të prodhuesit vendas ose kontratë furnizimi me 1(një) importues të mallrave si dhe lejen e importit të importuesit të lëshuar nga Komisioni i Liçensave pranë Ministrisë së Shëndetësisë për llojet e sasisë e kimikateve të përcaktuara në DST.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në zbatim të ligjit nr.10138, datë 11.05.2009”Për Shëndetin Publik”, ligji nr.10081, datë 23.02.2009”Për liçensat , autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, gjithashtu mbështetur edhe në pikën 1 të Vendimit nr. 415, date 17.08.1993 të Këshillit të Ministrave ”Për licencimin eeksportit, importit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të substancave për desinfektim,dezinsektim dhe deratizim” parashikohet se: “Importimi, eksportimi, magazinimi dhe tregtimi me shumicë e pakicë i lëndëve dezinfektante, dezinfektante e deratizuese për persona komunal, në banesa dhe objekte të ndryshme sociale nga persona juridikë e fizikë, si dhe nga individë të ndryshëm, bëhet me leje (licencë) që jepet nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit.

Ky kriter është vendosur në mbështetje të vendimit nr. 379 date 25.05.2016 neni 14, pika 1 në të cilën sanksionohet: “Për trajtimin e ujit të pijshëm lejohet të përdoren vetëm lëndët kimike të miratuara/autorizuara sipas legjislacionit përkatës për produktet biocide” dhe kimikatet objekt prokurimi (produkte biocide) që u lejohet leja e importit janë të përcaktuara në urdhërin nr.202 date 23.05.2014 nga Ministria e Shëndetësisë “Për autorizimin e importit të produkteve biocide dhe miratimin e listës së produkteve biocide për dezinfektimin, deratizimin dhe dezinfektimin në Shëndetin Publik dhe produkteve për trajtimin e ujit të pijshëm të lejuara për tregtim dhe përdorim në Republikën e Shqipërisë.

Referuar vendosjes të lejes mjedisore të tipit A në rastin kur operatori ekonomik është prodhues vendas apo kur operatori ekonomik është tregtues vendas kriteri është vendosur në zbatim të ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011”Për lejet e mjedisit” të ndryshuar.

Në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011”Për lejet e mjedisit” parashikohet se

“Leje mjedisi e tipit A” është leja për veprimtaritë e përcaktuara në aneksin 1/A, e përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe e firmosur nga ministri, të lëshuar nga QKL-ja, që i jep të drejtën e funksionimit, tërësisht ose pjesërisht, instalimit të tipit A, sipas përcaktimit të këtij ligji, dhe që përmban të shkruara kushtet e nevojshme për të garantuar se instalimi përmbush kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi. Një leje mund të mbulojë një ose më shumë instalime ose pjesë të instalimeve në të njëjtën vendndodhje dhe që operohen nga një i njëjti operator.

Në aneksin 1/A parashikohet shprehimisht veprimtaria “Prodhimi i kimikateve inorganike bazë (4.2)”.

*Përderisa tipi i lejes A përfshin në veprimtarinë e saj “Prodhimi i kimikateve inorganike bazë (2)” atëherë domosdoshmërisht operatori ekonomik prodhues i interesuar për procedurën objekt prokurimi duhet të jetë i licënsuar për prodhimin e kimikateve inorganike bazë me qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi.*

*Sa më sipër në vlerësimin e Autoriteti Kontraktor ky kriter ligjor është i domosdoshëm pasi objekti i prokurimit për vetë natyrën e tij ka një impakt social të rëndësishëm pasi bëhet fjalë për ujin e pijshëm ndaj edhe garancitë që Autoriteti Kontraktor synon të përftojë me anë të vendosjes së kritereve duhet të jenë të një niveli të lartë për të konkluduar me përmbushjen e suksesshme të kontratës objekt prokurimi.*

2.11 Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik fletën e analizës nga Instituti i Shëndetit Publik për analizat si më poshtë :

*Ngjyra dhe Era, Plumbi(Pb), Kadmiumi (Cd),Kromi (Cr), Nikeli(Ni), Densiteti ose*

*Analizimi i metaleve të rënda të kimikateve të bëhet në një laborator të licënsuar (vëndas ose të huaj), Qender Kerkimore (IKV,IFBZ) apo Universitare që ka kapacitete dhe aparatura të analizoje metalet e rënda në produkte të ndryshme, përfshirë dhe kimikatet e siperpermendura.(Për të gjithë elementet të cilët nuk kryhen nga Instituti i Shëndetit Publik).*

*Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të nenit 40 “të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar në të cilën parashikohet shprehimisht.... Se Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

*b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose*

*c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

Sa më sipër në vlerësimin e Autoriteti Kontraktor ky kriter ligjor është i domosdoshëm pasi objekti i prokurimit për vetë natyrën e tij ka një impakt social të rëndësishëm pasi bëhet fjalë për ujin e pijshëm ndaj edhe garancitë që Autoriteti Kontraktor synon të përftojë me anë të vendosjes së kritereve duhet të jenë të një niveli të lartë për të konkluduar me përmbushjen e suksesshme të kontratës objekt prokurimi.

Në mbështetje të bazës ligjore të sipërpërmendur njësia e prokurimit gjykon se vendosja e kërkesës së mësipërme në kushtet e veçanta të kualifikimit AK ka për qëllim të vërtetojë se për produktet që prokurohen nuk do të përmbahen lëndë të huaja dhe toksike të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e popullatës

**2.12.**Një punësim mesatar i të paktën 3(tre) personave, për muajin e fundit të vërtetuar me;

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit;
- List pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislati në fuqi për muajin e fundit.

(Nëse operatori ekonomik oferton per lote te vecanta, nr.i punonjësve duhet ti korrespondojë numrit të punonjësve të kërkuar në lotin që oferton, ose shumes se loteve qe oferton)

**2.13.**Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të paktën 1 (një) kimist dhe një drejtues mjete ( brenda numrit të kërkuar në pikën 2.12).

- Për punonjësën “Kimist” operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomë, dhe kontratë pune (e vlefshme per të paktën periudhën e parashikuar)
- Për punonjësën “Drejtues mjete” dokumentat që duhet të paraqes janë: Leje drejtimi për mjete që kryejn transportin e lëndëve të rrezikshme (ADR) (e vlefshme) si dhe te figurojë në listpagesat e muajit të fundit të shoqërisë.
- Për rastin kur mjetet dhe makineritë sigurohen nëpermjet kontratës së qerasë atehere operatori ekonomik për punonjësën “Drejtues mjete” duhet të paraqesë **kontratë punësimi** për vetëdeklarimet mbi punonjësit e kërkuar në DST.

**Shënim:** Për pikat 2.12, 2.13 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma b), gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Referuar specifikimeve në dosjen e procedures është përcaktuar se përvec furnizimit të mallit objekt prokurimi do të kryhet edhe shpërndarja e tyre pranë vend-dorezimit te tyre në Impiantin e Trajtimit të Ujit Bovillë), pra për këtë arsye është e domosdoshme që operatorët e mundshëm ekonomikë duhet të dëshmojnë fuqinë e kërkuar punëtore të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimi.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpermjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Sa më sipër në vlerësimin e Autoriteti Kontraktor mbi kërkesën e një kimisti është i domosdoshëm pasi objekti i prokurimit për vetë natyrën e tij ka një impakt social të rëndësishëm pasi bëhet fjalë për ujin e pijshëm ndaj edhe garancitë që Autoriteti Kontraktor

synon të përftojë me anë të vendosjes së kriterëve duhet të jenë të një niveli të lartë për të konkluduar me përmbushjen e suksesshme të kontaktës objekt prokurimi.

*Në specifikimet teknike të procedurës objekt prokurimi përcaktohet se ....*

*Firma furnizuese që nga momenti kur në mënyrë të verbalizuar është lajmëruar për faktin e mospërputhjes së cilësisë së ngarkesës me specifikimet teknike në përputhje me të cilat ka fituar garën, ka 10 ditë kohë për të prezantuar kundërshtitë e veta, në të kundërt e humb këtë të drejtë.*

*Në rastin konkret operatori ekonomik kontraktues ka të nevojshëm disponimin e një kimisti (specialisti të fushës) me qëllim verifikimin e dokumentacionit teknik të produkteve nga ana cilësore dhe e elementëve të sigurisë në rastin kur janë rishitës të mallit, apo në rastin kur janë prodhues të mallrave objekt prokurimi me qëllim verifikimin dhe kontrollin e produktit nga ana cilësore dhe e elementëve të sigurisë, si dhe më pas prezantimin e kundërshtive që mund të ketë operatori ekonomik kontraktues mbi faktin e mospërputhjes të cilësisë të ngarkesës të kimikateve.*

*Sa më sipër në vlerësimin e Autoriteti Kontraktor mbi kërkesën e një kimisti është i domosdoshëm pasi referuar specifikimeve teknike analiza e produktit të reklamuar do të bëhet në bashkëpunim ndërmjet kimistit të impiantit dhe kimistit të shoqërisë kontraktuese në mënyrë që pretendimet e të dy palëve të jenë minimale. Theksojmë se kryerja bashkërisht e analizave të kimistit të UKT sh.a si dhe kimistit të shoqërisë kontraktuese eliminon, minimizon mosmarrvëshjet ndërmjet palëve respektive. Konkretisht në rast se do të kishim mosmarrvëshje në kolaudimin e mallit do të sillte për rrjedhojë bllokim të procesit të punës (trajtimin të ujit me kimikate) dhe për pasojë duke shkaktuar mungesë të ujit tek qytetarët e Tiranës.*

**2.14** Operatori ekonomik për Loti 2“Blerje Acid Klorhidrik 30-33%, duhet të ketë në pronësi ose me qera 1 mjet (autobot) të autorizuar për transport kimikatesh Gjithashtu për transportin e këtyre kimikateve mund të përdoren depozita 1000 l IBC (intermediate bulk container) të jete të vulosura, të pajisura me certifikatat e testimit dhe certifikatat ADR për secilin depozitë, dhe të miraturot në përputhje me dispozitat ADR sipas ligjit Nr. 118/2012 „PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE TË RREZIKSHME“ për arsye se këto kimikate klasifikohen si produkt ADR me kodet si më poshtë

Kodi UN1789, ADR 1789 solucion ACID KLOORHIDRIK

Kamioni që transporton kimikatet me këto depozita 1000 l duhet gjithashtu të jete i pajisur me certifikate (ADR) për transport lëndesh të rrezikshme (KIMIKATE).

Nëse operatori ekonomik oferton për më shumë se një lot, duhet të vetëdeklarojë, se disponon mjete transporti për secilin nga kimikatet që do të transportojë, sipas specifikimeve teknike të kërkuara për këtë procedurë prokurimi.

Për të vërtetuar disponimin e mjeteve të kërkuara më lart operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

a)Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi) per “Transport lende te rrezikshme” ,lejen e qarkullimit, plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme) dhe per mjetet e siguruar me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme), duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

b)Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

c)Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

d)Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për mjetet e deklaruar ku të jenë të dukshme dhe targat e mjetit.

e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë në sistemin elektronik se disponon mjete për të realizuar kontratën objekt prokurimi.

**Shënim:** Për pikat 2.14 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Githashtu referuar specifikimeve te administruar ne dosjen e procedures është përcaktuar përvec furnizimit të mallit objekt prokurimi do të kryhet transporti dhe vendosja e tyre pranë vend-dorezimit te tyre ne destinacionin perkates, për këtë arsye kapaciteti i mjetit të kërkuar lidhet ngushtë me nevojat e autoritetit kontraktor për furnizimin me Acid Klorhidrik.

Pra për këtë arsye është e domosdoshme që operatorët e mundshëm ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi mbi pajisjet teknike që kanë në dispozicion për të përmbushur kontratën objekt prokurimi.



**2.15.** Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, si dhe të gjitha shpenzimet e parashikuara në shtojcën 5 të specifikimeve teknike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë ,markë,emër i veçantë , patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre

**Loti 3“Blerje Poliklorur alumini 10±0.5 %**

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3: për Loti 3: “Blerje Poliklorur Alumini 10±0.5 %” është 1,531.200 (një milion e peseqind e tridhjetë e nje mije e dyqind ) lekë si dhe në monedhën euro 14,765,67 (katërmbedhjetë mije e shtateqind e gjashtedhjetë e pese presje gjashtedhjetë e shtate ) euro.*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

## 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

---

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit të lotit të tretë.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Nëse operatori ekonomik oferton për lote të veçanta, vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës të kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të lotit përkatës, ose shumë se loteve që oferton).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" e ndryshuar

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, pika 2, si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) "Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise", Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet forms elektronike".

**2.2.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022) të çertifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kriteri quhet i përmbushur nëse në bilancet e 2 viteve të njëpasnjëshme nuk kanë raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", rekomandimit të Agjencisë të Prokurimit Publik nr.7998, datë 24.12.2021.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

**2.2.3.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar; **(lidhur me afatet e kryerjes se pagesave te caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2022)**, në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

*(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*

**2.2.4.** Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2023 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me vetëdeklarimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

### **2.3Aftësitë teknike dhe profesionale:**

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të lotit të tretë, / shumatores së loteve për të cilën oferton.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

g) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku

të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,  
ose

- h) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77/4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit të lotit të tretë / shumatores së loteve për të cilën oferton., që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

- i) Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e fondit limit.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

---

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

## **Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim**

### **2.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë:**

- Autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor . Në rast se do të paraqitet kjo e fundit duhet të vertetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 73 datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar neni 40, pika 6, germa “c”, i jep mundësinë autoriteteve kontraktorë t’u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi.

Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses.

Për autoritetin është e rëndësishme që të sigurohet “mall” sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për tu paraqitur është i parashikuar dhe brenda kuadrit ligjor të parashikuar në dispozitat ligjore.

**2.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Të disponojë Çertifikatën **SSH 45001:2018** e vlefshme mbi “Sistemin për Menaxhimin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë”. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zerave që do të marre persiper sipas akt-marreveshjes).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

*ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshatshmërinë e burimeve të tij, kompetencen/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve,*

veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

14001:2015 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit mjedisor që një organizatë mund të përdorë për të përmirësuar performancën e saj mjedisore. ISO 14001:2015 është menduar për përdorim nga një organizatë që kërkon të menaxhojë përgjegjësitë e saj mjedisore në një mënyrë sistematike që kontribuon në shtyllën mjedisore të qëndrueshmërisë. ISO 14001:2015 ndihmon një organizatë të arrijë rezultatet e synuara të sistemit të saj të menaxhimit mjedisor, të cilat ofrojnë vlerë për mjedisin, vetë organizatën dhe palët e interesuara.

ISO 14001:2015 është i zbatueshëm për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia, lloji dhe natyra, dhe zbatohet për aspektet mjedisore të aktiviteteve, produkteve dhe shërbimeve të saj që organizata përcakton se mund t'i kontrollojë ose ndikojë duke marrë parasysh perspektivën e ciklit jetësor.

Çertifikata SSH 45001:2018 e vlefshme mbi “Sistemin për Menaxhimin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë”.

Standardi ISO 45001 i Sistemit të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë do të sigurojë një përfundim të rëndësishëm në parandalimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale që janë një barrë e madhe për bizneset. Standardi ISO 45001 ofron një kornizë për bizneset anembanë botës për të zvogëluar rreziqet në vendin e punës, për të rritur sigurinë e punonjësve dhe për të krijuar kushte më të besueshme të punës dhe përfshin kërkesa për të zvogëluar barrën ndaj tyre.

**2.8.** Në rast se operatori ekonomik ofertues nuk është prodhues operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë vetëdeklarim me anë të së cilës duhet të deklarojë se mallrat janë konform normave SSH EN 17034:2018.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit në sistemin elektronik.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, çertifikatën e prodhuesit konform normave, SSH 17034:2018.

**Argumentim:** Njësia e Prokurimit gjykon se paraqitja e çertifikatës që verteton konformitetin e produktit në prokurim me normat SSH EN 17034:2018 Produkte kimike për tregtimin e produkteve për trajnimin e ujit të destinuar për konsum njerëzor, konform normave të mësipërme, është i rëndësishëm për autoritetin kontraktor në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së mallrave konform normave të mësipërme, për shkak dhe objektit të veçantë jetik siç janë trajtimi i ujit me kimikate me qëllim demonstrimin dhe plotësimin e parametrave të cilësisë si dhe karakteristikat kimike të produkteve të ofruara me qëllim realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi.

**2.9** Operatori ekonomik ofertues (në rastin kur nuk ehte prodhues) duhet të paraqesë në sistemin elektronik një vetëdeklarim me anë të së cilit duhet të deklarojë se në momentin e dorëzimit të mallit do të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor çertifikatën nr.Rech të prodhuesit i cili vërteton dhe identifikon se prodhuesi(t) është i regjistruar dhe i çertifikuar për tregtimin e produkteve kimike për trajtimin e ujit për konsumim njerëzor.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit në sistemin elektronik.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” .

Çertifikata reach e prodhuesit është një çertifikatë e cila dëshmon se prodhuesi i mallrave operon për të përmirësuar mbrojtjen e shëndetit të njerëzve nga rreziqet që mund të paraqesin kimikatet, se si substanca mund të përdoret në mënyrë të sigurt në shëndetin e populltaës. Pra duke qënë se furnizimi më ujë i qytetarëve të bashkisë Tiranë është jetik, në mënyrë që trajtimi i ujit me kimikate të përdoret në mënyrë të sigurtë për shëndetin e popullates.

**2.10.** Në rast se operatori ekonomik është importues atëherë duhet të paraqesë në sistemin elektronik lejen e importit të lëshuar nga Komisioni i Liçensave pranë Ministrisë së Shëndetësisë për llojet e sasisë e kimikateve të përcaktuara në DST.

Në rast se operatori ekonomik është prodhues vendas atëherë duhet të paraqesë në sistemin elektronik leje mjedisore e tipit A të lëshuar nga QKL për të gjitha kimikatet e kërkuara nga AK.

Në rast se operatori ekonomik është tregtues vendas atëherë operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik kontratë furnizimi me një prodhues vendas shoqëruar me lejen mjedisore e tipit A të lëshuar nga QKL të prodhuesit vendas ose kontratë furnizimi me 1(një) importues të mallrave si dhe lejen e importit të importuesit të lëshuar nga Komisioni i Liçensave pranë Ministrisë së Shëndetësisë për llojet e sasisë e kimikateve të përcaktuara në DST.

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në zbatim të ligjit nr.10138, datë 11.05.2009”Për Shëndetin Publik”, ligji nr.10081, datë 23.02.2009”Për liçensat , autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, gjithashtu mbështetur edhe në pikën 1 të Vendimit nr. 415, date 17.08.1993 të Këshillit të Ministrave "Për licencimin eeksportit, importit dhe shitjes me shumicë dhe pakicë të substancave për desinfektim,dezinsktim dhe deratizim" parashikohet se: “Importimi, eksportimi, magazinimi dhe tregtimi me shumicë e pakicë i lëndëve dezinfektante, dezinsktante e deratizuese për persona komunal, në banesa dhe objekte të ndryshme sociale nga persona juridikë e fizikë, si dhe nga individë të ndryshëm, bëhet me leje (licencë) që jepet nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit.

Ky kriter është vendosur në mbështetje të vendimit nr. 379 date 25.05.2016 neni 14, pika 1 në të cilën sanksionohet: “Për trajtimin e ujit të pijshëm lejohet të përdoren vetëm lëndët kimike të miratuara/autorizuara sipas legjislacionit përkatës për produktet biocide” dhe kimikatet objekt prokurimi (produkte biocide) që u lejohet leja e importit janë të përcaktuara në urdhërin nr.202 date 23.05.2014 nga Ministria e Shëndetësisë “Për autorizimin e importit të produkteve biocide dhe miratimin e listës së produkteve biocide për dezinfektimin, deratizimin dhe dezinsktimin në Shëndetin Publik dhe produkteve për trajtimin e ujit të pijshëm të lejuara për tregtim dhe përdorim në Republikën e Shqipërisë.

*Referuar vendosjes të lejes mjedisore të tipit A në rastin kur operatori ekonomik është prodhues vendas apo kur operatori ekonomik është tregtues vendas kriteri është vendosur në zbatim të ligjit nr. 10 448, datë 14.7.2011”Për lejet e mjedisit” të ndryshuar.*

*Në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011”Për lejet e mjedisit” parashikohet se*

*“Leje mjedisi e tipit A” është leja për veprimtaritë e përcaktuara në aneksin 1/A, e përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe e firmosur nga ministri, të lëshuar nga QKL-ja, që i jep të drejtën e funksionimit, tërësisht ose pjesërisht, instalimit të tipit A, sipas përcaktimit të këtij ligji, dhe që përmban të shkruara kushtet e nevojshme për të garantuar se instalimi përmbush kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi. Një leje mund të mbulojë një ose më shumë instalime ose pjesë të instalimeve në të njëjtën vendndodhje dhe që operohen nga një i njëjti operator.*

*Në aneksin 1/A parashikohet shprehimisht veprimtaria “Prodhimi i kimikateve inorganike bazë (4.2)”.*

*Përderisa tipi i lejes A përfshin në veprimtarinë e saj “Prodhimi i kimikateve inorganike bazë (2)” atëherë domosdoshmërisht operatori ekonomik prodhues i interesuar për procedurën objekt prokurimi duhet të jetë i licensuar për prodhimin e kimikateve inorganike bazë me qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi.*

*Sa më sipër në vlerësimin e Autoriteti Kontraktor ky kriter ligjor është i domosdoshëm pasi objekti i prokurimit për vetë natyrën e tij ka një impakt social të rëndësishëm pasi bëhet fjalë për ujin e pijshëm ndaj edhe garancitë që Autoriteti Kontraktor synon të përftojë me anë të vendosjes së kritereve duhet të jenë të një niveli të lartë për të konkluduar me përmbushjen e suksesshme të kontratës objekt prokurimi.*

2.11 Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik fletën e analizës nga Instituti i Shendetit Publik për analizat si më poshtë :

*Ngjyra dhe Era, Plumbi(Pb), Kadmiumi (Cd),Kromi (Cr), Nikeli(Ni), Densiteti ose*

*Analizimi i metaleve të rënda të kimikateve të bëhet në një laborator të licensuar (vëndas ose të huaj), Qender Kerkimore (IKV,IFBZ) apo Universitare që ka kapacitete dhe aparatura të analizoje metalet e rënda në produkte të ndryshme, përfshirë dhe kimikatet e sipërpermendura.(Për të gjithë elementet të cilët nuk kryhen nga Instituti i Shendetit Publik).*

***Argumentim:** Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të nenit 40 “të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar në të cilën parashikohet shprehimisht.... Se Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

*b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose*

*c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

*Sa më sipër në vlerësimin e Autoriteti Kontraktor ky kriter ligjor është i domosdoshëm pasi objekti i prokurimit për vetë natyrën e tij ka një impakt social të rëndësishëm pasi bëhet fjalë për ujin e pijshëm ndaj edhe garancitë që Autoriteti Kontraktor synon të përftojë me anë të vendosjes së kritereve duhet të jenë të një niveli të lartë për të konkluduar me përmbushjen e suksesshme të kontratës objekt prokurimi.*



Në mbështetje të bazës ligjore të sipërpërmendur njësia e prokurimit gjykon se vendosja e kërkesës së mësipërme në kushtet e veçanta të kualifikimit AK ka për qëllim të vërtetojë se për produktet që prokurohen nuk do të përmbajnë lëndë të huaja dhe toksike të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e popullatës

**2.12.**Një punësim mesatar i të paktën 3(tre) personave, për muajin e fundit të vërtetuar me;

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqerore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit;
- List pagesat e punonjesve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.

(Nëse operatori ekonomik oferton për lote të veçanta, nr.i punonjësve duhet të korrespondojë numrit të punonjësve të kërkuar në lotin që oferton, ose shumës së loteve që oferton)

**2.13.**Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre të paktën 1 (një) kimist dhe një drejtues mjete ( brenda numrit të kërkuar në pikën 2.12).

- Për punonjës të "Kimist" operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomë, dhe kontratë pune (e vlefshme për të paktën periudhën e parashikuar)

- Për punonjës të "Drejtues mjete" dokumentat që duhet të paraqes janë: Leje drejtimi për mjete që kryejn transportin e lëndëve të rrezikshme (ADR) (e vlefshme) si dhe të figurojë në listpagesat e muajit të fundit të shoqërisë.

- Për rastin kur mjetet dhe makineritë sigurohen nëpërmjet kontratës së qerasë atëherë operatori ekonomik për punonjës të "Drejtues mjete" duhet të paraqesë **kontratë punësimi** për vetëdeklarimet mbi punonjësit e kërkuar në DST.

**Shënim:** Për pikat 2.12, 2.13 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma b), gërma c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Referuar specifikimeve në dosjen e procedurës është përcaktuar se përveç furnizimit të mallit objekt prokurimi do të kryhet edhe shpërndarja e tyre pranë vend-dorezimit të tyre në Impiantin e Trajtimit të Ujit Bovillë), pra për këtë arsye është e domosdoshme që operatorët e mundshëm

ekonomikë duhet të dëshmojnë fuqinë e kërkuar punëtorë të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimi.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

Sa më sipër në vlerësimin e Autoriteti Kontraktor mbi kërkesën e një kimisti është i domosdoshëm pasi objekti i prokurimit për vetë natyrën e tij ka një impakt social të rëndësishëm pasi bëhet fjalë për ujën e pijshëm ndaj edhe garancitë që Autoriteti Kontraktor synon të përftojë me anë të vendosjes së kriterëve duhet të jenë të një niveli të lartë për të konkluduar me përmbushjen e suksesshme të kontratës objekt prokurimi.

*Në specifikimet teknike të procedurës objekt prokurimi përcaktohet se ....*

*Firma furnizuese që nga momenti kur në mënyrë të verbalizuar është lajmëruar për faktin e mospërputhjes së cilësisë së ngarkesës me specifikimet teknike në përputhje me të cilat ka fituar garën, ka 10 ditë kohë për të prezantuar kundërshtitë e veta, në të kundërt e humb këtë të drejtë.*

*Në rastin konkret operatori ekonomik kontraktues ka të nevojshëm disponimin e një kimisti (specialisti të fushës) me qëllim verifikimin e dokumentacionit teknik të produkteve nga ana cilësore dhe e elementëve të sigurisë në rastin kur janë rishitës të mallit, apo në rastin kur janë prodhues të mallrave objekt prokurimi me qëllim verifikimin dhe kontrollin e produktit nga ana cilësore dhe e elementëve të sigurisë, si dhe më pas prezantimin e kundërshtive që mund të ketë operatori ekonomik kontraktues mbi faktin e mospërputhjes të cilësisë të ngarkesës të kimikateve.*

*Sa më sipër në vlerësimin e Autoriteti Kontraktor mbi kërkesën e një kimisti është i domosdoshëm pasi referuar specifikimeve teknike analiza e produktit të reklamuar do të bëhet në bashkëpunim ndërmjet kimistit të impiantit dhe kimistit të shoqërisë kontraktuese në mënyrë që pretendimet e të dy palëve të jenë minimale. Theksojmë se kryerja bashkërisht e analizave të kimistit të UKT sh.a si dhe kimistit të shoqërisë kontraktuese eliminon, minimizon mosmarrvëshjet ndërmjet palëve respektive. Konkretisht në rast se do të kishim mosmarrvëshje në kolaudimin e mallit do të sillte për rrjedhojë bllokim të procesit të punës (trajtimin e ujit me kimikate) dhe për pasojë duke shkaktuar mungesë të ujit tek qytetarët e Tiranës.*

2.14 Operatori ekonomik për Loti 3“Blerje Poliklorur alumini  $10\pm 0.5$  %, duhet të ketë në pronësi ose me qera 1 mjet (autobot) të autorizuar për transport kimikatesh Gjithashtu për transportin e këtyre kimikateve mund të përdoren depozita 1000 l IBC (intermedite bulk container) të jete të vulosura, të pajisura me certifikatat e testimit dhe certifikatat ADR për secilin depozitë, dhe të miratura në përputhje me dispozitat ADR sipas ligjit Nr. 118/2012

„PER TRANSPORTIN E MALLRAVE TE RREZIKSHME“ per arsye se keto kimikate klasifikohen si produkt ADR me kodet si me poshte

Kodi ADR 3264 solucion POLIKLORUR ALUMINI

Kamioni qe transporton kimikatet me keto depozita 1000 l duhet gjithashtu te jete i pajisur me certifikate (ADR) per transport lendesh te rrezikshme (KIMIKATE).

Nëse operatori ekonomik oferton për më shumë se një lot, duhet të vetëdeklarojë, se disponon mjete transporti për secilin nga kimikatet që do të transportojë, sipas specifikimeve teknike të kërkuara për këtë procedurë prokurimi.

Për të vërtetuar disponimin e mjeteve të kërkuara më lart operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

*a)Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi) per “Transport lende te rrezikshme” ,lejen e qarkullimit, plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme) dhe per mjetet e siguruara me qera, dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme), duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.*

*b)Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*

*c)Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*

*d)Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për mjetet e deklaruar ku të jenë të dukshme dhe targat e mjetit.*

*e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë në sistemin elektronik se disponon mjete për të realizuar kontratën objekt prokurimi.*

**Shënim:** Për pikat 2.14 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit

**Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Githashtu referuar specifikimeve të administruar në dosjen e procedurës është përcaktuar përveç furnizimit të mallit objekt prokurimi do të kryhet transporti dhe vendosja e tyre pranë vend-dorezimit të tyre në destinacionin perkates, për këtë arsye kapaciteti i mjetit të kërkuar lidhet ngushtë me nevojat e autoritetit kontraktor për furnizimin me Poliklorur alumini  $10\pm 0.5\%$ .

2.15.Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, si dhe të gjitha shpenzimet e parashikuara në shtojcën 5 të specifikimeve teknike.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë ,markë,emër i veçantë , patentë,vizatim ose tip,origjine specifike,prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre

### **Argumentim mbi specifikimet teknike:**

Vendosja e specifikimeve teknike është bërë në përputhje me Standartet Europiane Shqiptare, si dhe në VMK nr. 379 datë 25.05.2016, ku përcaktohen menyrat e trajtimit të ujërave sipërfaqësore për tu kthyer në ujë të pijshëm për qytetaret e Bashkisë Tiranë.

Përdorimi i këtyre kimikateve për trajtimin e ujit në impiantin e Bovillës është përcaktuar edhe nga projektuesi i këtij impianti në përputhje me Standartet që kërkohen. Përdorimi i këtyre kimikateve si nga ana sasiore dhe ajo cilësore janë të pasqyruara në Manualin e funksionimit të këtij impianti.

### **Njësia e Prokurimit**